



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK
DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGINËS

Nr. 25512
Prot.

Tiranë, më 23.12.2025

Lënda: Njoftimi në lidhje me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mesdhetare ose të protokolleve për rregullat e origjinës të cilat sigurojnë zbatimin e kumulimit diagonal ndërmjet palëve kontraktuese me këtë Konventë.

DEGËVE DOGANORE

AGJENSIVE DOGANORE

DEPARTAMENTEVE NË DPD

Në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian No C/2025/6212 është publikuar njoftimi lidhur me zbatimin e Konventës Rajonale për rregullat e origjinës preferenciale pan-Euro-Mesdhetare¹ ose të protokolleve për rregullat e origjinës, të cilat sigurojnë zbatimin e kumulimit diagonal ndërmjet palëve kontraktuese me këtë Konventë si dhe matricat përkatëse.

Për qëllim të zbatimit të kumulimit diagonal të origjinës ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mesdhetare¹ (më tej referuar si 'Konventa'), Palët e interesuara njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet Komisionit Evropian, mbi rregullat e origjinës në fuqi me Palët e tjera.

Kumulimi diagonal

Kumulimi diagonal mund të zbatohet vetëm nëse vendet e prodhimit përfundimtar dhe të destinacionit përfundimtar *zbatojnë Marrëveshje të Tregtisë së Lirë ndërmjet tyre dhe përmbajnë rregulla identike të origjinës me të gjitha palët e përfshira në përfshimin e statusit origjinues, psh: me të gjitha palët nga të cilat materialet e përdorura origjinojnë*. Materialet origjinuese në një vend i cili nuk ka një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me vendet e prodhimit përfundimtar dhe/ose të destinacionit përfundimtar do të trajtohen si jo-origjinuese. Shembuj specifikë jepen në notat shpjeguese lidhur me protokollin pan-Euro-Mesdhetare të rregullave të origjinës²

Në Tabelat bashkangjitur nr. 1, 2 dhe 3 jepet informacion specifik lidhur me mundësitë e zbatimit të kumulimit diagonal bazuar në notifikimet që palët kanë dërguar në Komisionin Evropian:

Shpjegime lidhur me Tabelat 1, 2 dhe 3

¹ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian Nr. L 54, datë 26.02.2013, p.4 dhe Fletore zyrtare e Shqipërisë Nr 1/2012, datë 26.01.2012

² Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian Nr. C 83, datë 17.04.2007, p.1

Tabela 1. Pamje e përgjithshme e thjeshtuar e mundësive të kumulimit diagonal në zonën pan-Euro-Mesdhetare.

Simboli "C" tregon ekzistencën e një marrëveshje të tregtisë së lirë ndërmjet 2 partnerëve, e cila përmban rregulla të origjinës që lejojnë zbatimin e kumulimit diagonal bazuar në rregullat e origjinës së vitit 2012, të Konventës pan-Euro-Mesdhetare³. Për të zbatuar kumulimin diagonal me një vend të tretë partner, simboli "C" duhet të jetë prezent në të gjitha kryqëzimet e tabelës ndërmjet tre vendeve partnere.

Simboli "R" tregon ekzistencën e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë ndërmjet 2 partnerëve, e cila përmban rregulla të origjinës që lejojnë kumulimin bazuar në rregullat e origjinës së vitit 2023⁴. Për të zbatuar kumulimin diagonal me një vend të tretë partner, simboli "R" duhet të jetë prezent në të gjitha kryqëzimet e tabelës ndërmjet tre vendeve partnere.

Për qëllimin e zbatimit të dispozitave kalimtare të parashikuara në Vendimin 2/2024 të KP të PEM ndërmjet dy palëve në Konventë, materialet origjinuese në një palë tjetër në përputhje me rregullat e 2012 mund të përdoren në kumulim sipas rregullave të 2023 duke zbatuar parimin e përshkueshmërisë siç parashihet në nenin e vetëm, paragrafi 2 i këtij vendimi.

Megjithatë, ka disa përjashtime nga kumulimi diagonal. Në të tilla raste, ose (1) ose një (*) tregojnë përjashtimet që duhen marrë parasysh në tregtinë që vendi ynë zbaton me vendet pjesëmarrëse në Konventë.

Simboli (*) tregon se ndërmjet Shqipërisë, Turqisë, Kosovës, Bosnje&Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë zbatohet Kumulimi diagonal. Megjithatë, për të parë mundësitë e zbatimit të këtij kumulimi ndërmjet BE, Turqisë, Bosnje&Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë duhet ti referohemi Tabelës 3 bashkangjitur.

Simboli (¹) tregon se Kumulimi diagonal zbatohet vetëm për mallrat e mbuluara nga Bashkimi Doganor BE-Turqi, pra nuk zbatohet për produktet agrare si dhe produktet e qymyrit dhe çelikut (shih në tabelën nr.3).

Tabela 2. Data e zbatimit të rregullave të origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal në zonën pan-Euro-Med.

- Data tregon datën e zbatimit të kumulimit diagonal, bazuar në Nenin 3 të Shtojcës I të Konventës, kur Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në fjalë i është referuar Konventës. Në këto raste data paraprihet nga gërma "C";
- Data e zbatimit të protokolleve mbi rregullat e origjinës që i paraprijnë Konventës që parashikojnë kumulimin diagonal të bashkëngjitur marrëveshjes së tregtisë së lirë në fjalë, në raste të tjera;

³ Rregullat e vitit 2012: rregullat në Shtojcën 1 të Konventës botuar në FZ të BE nr. L54 të datës 26 shkurt 2013 dhe FZ e Shqipërisë Nr 1/2012, datë 26.01.2012

⁴ Rregullat e 2023: rregullat në Shtojcën 1 të Konventës në versionin e saj të ndryshuar me Vendimin Nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët PEM, (publikuar në FZ të BE nr. L 2024 390, datë 19 shkurt 2024 dhe Ligji ynë 59/2024 datë 6 qershor 2024 publikuar në FZ nr.113 datë 4 korrik 2024).

- Data e zbatimit të kumulimit diagonal në bazë të nenit 7 të shtojcës I të Konventës, i ndryshuar me vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës, datë 7 dhjetor 2023⁵. Në këtë rast, data paraprihet nga "R".

Tabela 3. Data e zbatimit të protokolleve të rregullave të origjinës të marrëveshjeve përkatëse që sigurojnë kumulimin diagonal ndërmjet EU, Turqisë dhe vendeve të cilat janë pjesë e Procesit të Stabilizim Asociimit me BE-në.

Datat në Tabelën 3 tregojnë datat përkatëse të zbatimit të protokolleve mbi rregullat e origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal sipas Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë ndërmjet BE-së, Turqisë dhe vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim Asociimit.

Sa herë që një Marrëveshje e Tregtisë së Lirë ndërmjet Palëve në këtë tabelë i referohet Konventës, një datë e paraprirë nga gërma "C" dhe/ose "R" shtohet në Tabelën 2.

Gjithashtu ju kujtojmë se materialet origjinuese në Turqi dhe që mbulohen nga Bashkimi Doganor BE-Turqi mund të trupëzohen si materiale origjinuese për qëllime të kumulimit diagonal ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim Asociimit me të cilin është në fuqi një protokoll i origjinës.

Ky informacion zëvendëson informacionin "Mbi zbatimin e Rregullave të origjinës preferenciale që parashikojnë kumulimin diagonal ndërmjet palëve kontraktuese zbatuese të rregullave tranzitore në zonën pan-Euro-Mesdhetare" Nr. 4211 Prot i DPD datë 03.03.2025.

ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Pajtim Melani

NË MUNGESË DHE URDHËR

DREJTORI TARIKËS DHE ORIGJINËS

Benet Fociro



⁵ L. 2024/390, datë 19 shkurt 2024 dhe Ligji ynë 59/2024 datë 6 qershor 2024

Tabela 1
Pamje e përgjithshme e thjeshtuar e mundësive të kumulimit diagonal në zonën pan-Euro-Mesdhetare

	Vendet EFTA				TR	AL	Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizimit Asocimit					XS	MD
	BE	CH (+LI)	IS	NO			BA	KK	ME	MK			
BE		CR	CR	CR	C(1)	CR	CR	CR	CR	CR		CR	CR
CH (+LI)	CR		CR	CR	CR	CR	CR		CR	CR		CR	CR
IS	CR	CR		CR	CR	CR	CR		CR	CR		CR	CR
NO	CR	CR	CR		CR	CR	CR		CR	CR		CR	CR
TR	C(1)	CR	CR	CR		C(*)	C(*)	(*)	C(*)	C(*)		C(*)	C
AL	CR	CR	CR	CR	C(*)		CR	CR	CR	CR		CR	CR
BA	CR	CR	CR	CR	C(*)	CR		CR	CR	CR		CR	CR
KK	CR				(*)	CR			CR	CR		CR	CR
ME	CR	CR	CR	CR	C(*)	CR	CR			CR		CR	CR
MK	CR	CR	CR	CR	C(*)	CR				CR		CR	CR
RS	CR	CR	CR	CR	C(*)	CR			CR	CR			CR
MD	CR	CR	CR	CR	C	CR	CR	CR	CR	CR	CR	CR	

(*) Kumulimi diagonal zbatohet edhe ndërmjet Shqipërisë, Turqisë, Bosnje&Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë. Megjithatë, referojuni Tabelës 3, për të parë mundësitë e zbatimit të kumulimit diagonal ndërmjet BE, Turqisë, Bosnje&Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Serbisë.

(1) Për mallrat e mbuluar nga Bashkimi Doganor BE-Turqi, data e aplikimit është 27 Korrik 2006.

Për produktet bujqësore data e zbatimit është 1 Janar 2007, ndërsa

Për produktet e qymyrit dhe çelikut data e zbatimit është 1 Mars 2009.

Tabela 2
Data e zbatimit të rregullave të origjinës që siguron kumulimin diagonal në zonën pan-Euro-Med

Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizimit Asociimit													
Vendet EFTA													
	BE		CH (+LI)	IS	NO	TR	AL	BA	XK	ME	MK	XS	MD
MT	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025	(C)1.5.2015	(C)3.5.2021		(C)1.2.2015	(R)1.1.2025	(C)1.4.2014	(R)1.1.2025	(C)1.4.2014	(R)1.1.2025
TR	(¹)		(C)1.12.2019	(C)1.7.2013	(C)1.12.2019		(C)3.5.2021	(C)1.8.2021	1.09.2019	(C)1.6.2021	(C)1.8.2018	(C)1.06.2019	(C)1.10.2017
ON	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025	(C)1.7.2013	(C)1.7.2013		(C)1.12.2019	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025		(C)1.11.2012	(C)1.4.2022	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025
SI	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025	(C)1.7.2013		(C)1.7.2013	(C)1.12.2019	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025		(C)1.10.2012	(C)1.4.2022	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025
LI	(C)1.2.2016	(R)1.1.2025		(C)1.7.2013	(C)1.7.2013	(C)1.12.2019	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025		(C)1.9.2012	(C)1.4.2022	(C)1.5.2015	(R)1.5.2025
BE			(C)1.2.2016	(R)1.1.2025	(C)1.5.2015	(1)	(C)1.5.2015	(R)1.1.2025	(C)1.4.2016	(C)30.1.2025	(C)1.5.2015	(C)1.2.2015	(R)1.12.2016

Tabela 3

Data e zbatimit të Protokolleve të rregullave të origjinës që sigurojnë kumulimin diagonal ndërmjet EU, Turqisë, dhe vendeve të CEFTA-2006 që janë pjesë e Procesit të Stabilizim Asociimit

	BE	AL	BA	XK	MK	ME	XS	TR	
BE		1.1.2007	1.7.2008	1.4.2016	1.1.2007	1.1.2008	8.12.2009	(¹)	BE
AL	1.1.2007		22.11.2007	1.4.2014	26.7.2007	26.7.2007	24.10.2007	1.8.2011	CH (+LJ)
BA	1.7.2008	22.11.2007		1.4.2014	22.11.2007	22.11.2007	22.11.2007	14.12.11	IS
XK	1.4.2016	1.4.2014	1.4.2014		1.4.2014	1.4.2014	1.4.2014	1.9.2019	NO
MK	1.1.2007	26.7.2007	22.11.2007	1.4.2014		26.7.2007	24.10.2007	1.7.2009	TR
ME	1.1.2008	26.7.2007	22.11.2007	1.4.2014	26.7.2007		24.10.2007	1.3.2010	AL
XS	8.12.2009	24.10.2007	22.11.2007	1.4.2014	24.10.2007	24.10.2007		1.9.2010	BA
TR	(¹)	1.8.2011	14.12.2011	1.9.2019	1.7.2009	1.3.2010	1.9.2010		MK

(¹) për mallrat e mbuluara nga Bashkimi Doganor BE-Turqi data e zbatimit është 27 Korrik 2006. Nuk është i aplikueshëm për produktet agrare dhe produktet e qymyrit dhe çelikut.

Legjenda

BE	Bashkimi European
CH (+LJ)	Zvicër dhe Lihtenshtejn
IS	Islandë
NO	Norvegji
TR	Turqi
AL	Shqipëri
BA	Bosnje-Hecegovinë
MK	Maqedoni e Veriut
ME	Mali i Zi
XS	Serbi
XK	Kosovë
MD	Moldavi

ANEKSI I

Njoftimet në lidhje me lëshimin elektronik të certifikatave të qarkullimit EUR.1 dhe EUR-MED sipas paragrafit 1(d) të Rekomandimit nr. 1/2023 dhe Vendimit nr. 1/2024 të Komitetit të Përbashkët të Konventës

Sistemi Norvegjez: Altinn - portali qeveritar për dialogun dixhital midis bizneseve, individëve privatë dhe agjencive publike
Data e fillimit: 02.04.2020

Link për verifikimin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit: <https://eur1.toll.no>

Sistemi Turk: MEDOS - " Sistemi i Automatizimit për Certifikatat e Origjinës dhe Certifikatat e Lëvizjes"

Data e fillimit: 24 Prill 2018

Lidhja unike për çdo certifikatë lëvizjeje fillon me

"<https://mdc.gtb.gov.tr> , "<https://uygulama.gtb.gov.tr> , "<https://istanbul.ebirlik.net/>" and/or "<https://ankara.ebirlik.net/dolasim/app>" .
(aksesohet duke skanuar kodin QR në certifikatë ose duke shtypur shtegun e printuar në certifikatë)

ANEKSI II

Lista e Palëve Kontraktuese që kanë zgjedhur të zgjerojnë zbatimin e Nenit 7(3)

A. Lista e Palëve Kontraktuese Zbatuese që kanë zgjedhur të zgjerojnë zbatimin e Nenit 7(3) ndaj të gjithë partnerëve të tyre

— Islanda

— Norvegjia

— Zvicra (Lihtenshtajni)

B. Lista e Palëve Kontraktuese Zbatuese që kanë zgjedhur të zgjerojnë zbatimin e Nenit 7(3) ndaj një numri të kufizuar

të partnerëve të tyre

— Shqipëria – ndaj Shteteve të EFTA-s

— Mali i Zi – ndaj Shteteve të EFTA-s

— Maqedonia e Veriut – ndaj Shteteve të EFTA-s

— Serbia – ndaj Shteteve të EFTA-s

— Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizim-Asociimit të BE-së dhe Republika e Moldavisë (Palët e

Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore) – midis tyre